REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET
# 2024 - 2026

*Periudha janar – qershor 2025*

*Korrik 2025*

## Deklarata e Integritetit

Zbatimi i Planit të Integritetit gjatë periudhës janar – qershor 2025 ka qenë dhe mbetet një prioritet i pandryshuar. Edhe pse kemi hasur sfida – përfshirë vonesa të përkohshme në funksionimin e plotë të Asamblesë Komunale – kemi arritur të mbajmë fokusin tonë në përmirësimin e shërbimeve, transparencën dhe forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e interesit publik.

Duke pasur parasysh përgjegjësinë që kemi përpara qytetarëve dhe besimin që ata na kanë dhënë, si Kryetar i Komunës së Gjilanit e konsideroj integritetin si një prej shtyllave themelore të qeverisjes sonë lokale.

Ne jemi të përkushtuar ndaj politikës së "zero tolerancës" ndaj korrupsionit dhe ndaj ndërtimit të një administrate që vepron me përgjegjësi, profesionalizëm dhe etikë në shërbim të qytetarëve.

Kjo deklaratë është më shumë se një formalitet, është zotimi ynë për një qeverisje të hapur, të ndershme dhe llogaridhënëse. Jemi të vetëdijshëm se ndërtimi i një institucioni të besueshëm kërkon përkushtim të vazhdueshëm dhe përfshirje aktive të të gjithëve — qytetarëve, shërbyesve civilë dhe partnerëve tanë institucionalë.

Si Kryetar i Komunës së Gjilanit, mbështes fuqimisht çdo hap që rrit integritetin institucional dhe siguron që resurset publike të menaxhohen në mënyrë të drejtë, transparente dhe me synimin për të përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve tanë.

Së bashku, vazhdojmë të ndërtojmë një administratë të ndershme dhe një Komunë ku secili ndjehet i përfaqësuar, i dëgjuar dhe i respektuar.

***z. Alban Hyseni,***
***Kryetari i Komunës së Gjilanit***

**Hyrja**

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke iu referuar "Metodologjisë së Planeve të Integritetit", të gjitha institucionet janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Komuna e Gjilanit ka realizuar këtë detyrim duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Ky plan, i cili ka një periudhë zbatimi trevjeçare dhe përditësohet çdo vit, shërben si një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të integritetit brenda institucionit. Ai ofron masa të strukturuara për menaxhimin e integritetit, me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara për këtë fushë.

Planin për Integritetit për periudhën janar – qershor 2025 e gjeni të publikuar në ueb faqe të Komunës së Gjilanit

**Linku:**

https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Plani-per-Integritet-2024-2026-peridhua-TM1-dhe-TM2-2025.pdf

Plani thekson përkushtimin e komunës së Gjilanit për të forcuar kontrollin e aktiviteteve operative në të gjitha sektorët e veprimit të komunës. Ai përshkruan masat e bazuara në analizën e rrezikut për të arritur objektivat e institucionit, duke u fokusuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e vlerave dhe standardeve profesionale.

Kjo qasje sistematike dhe e dokumentuar është e nevojshme për të garantuar një nivel më të lartë të integritetit dhe transparencës në administratën lokale, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përgjegjshme.

## PERMBAJTJA E PLANI TE INTEGRITET

Përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimin e integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Institucioni.

## Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- Faza e parë**:** Drejtuesi/personi përgjegjës te institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë kredibilvarësi të kompleksitetit të institucioni ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

- Faza e dytë**:** Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përpunimit të të dhënave respektivisht përcaktimit të fushave të rrezikut dhe identifikimit të rreziqeve. Ndër të tjerash, takimet janë mbajtur më datë: 16.02.2023, 13.12.2023 dhe 12.01.2024. Përpos takimeve, jemi konsultuar në vazhdimësi përmes emailit dhe kemi kërkuar që anëtarët e grupit të dërgojnë komentet dhe propozimet e tyre në raport me Planin.

- Faza e tretë**:** Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t'i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresoj cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucion, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të Rrezikut

***<u>Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë</u>***:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave; dhe
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit.

### Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

***<u>Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:</u>***

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Menaxhimi i kontratave publike;
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi publik;
- Shëndeti publik.

# Tabela për Zbatimin e Planit të Integritetit-Komuna e Gjilanit – periudha janar - qershor 2025

| Të dhënat e Planit të Integritetit | | | | | | Raportimi i zbatimit | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** | **Veprimet e ndërmarra** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** | **Rekomandimet** |
| 1. | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Viti 2025 ka filluar me problemin kryesor – mos aprovimin e buxhetit për vitin 2025. | Kryetari i Komunës së Gjilanit ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha grupet politike parlamentare për të siguruar miratimin e buxhetit për vitin 2025 | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Të shumta janë organizuar konferenca të jashtëzakonshme dhe seanca urgjente me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për miratimin e buxhetit.<br><br>Përkundër përpjekjeve të deritanishme, nuk është arritur konsensus, por janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të vazhduar dialogun dhe arritur dakordim mes palëve.<br><br>Pavarësisht të gjitha vështirësive, Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, më 16 korrik (e mërkurë), në ora 19:30, në Parkun "Banja", do të prezantojë raportin gjashtëmujor të punës për këtë vit, me moton: "Çfarë realizuam së bashku". | **E realizuar!**<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-alban-hyseni-prezanton-raportin-gjashte-mujor-te-punes/ | https://2lonline.com/kryetari-i-komunes-i-bene-thirrje-opozites-per-te-reflektuar/<br><br>https://2lonline.com/kryetari-i-gjilanit-alban-hyseni-fton-ne-takim-kryetarin-e-deges-se-ldk-se-lutfi-hazirin-dhe-ate-te-pdk-se-riad-rashitin/ | Mospajtimet ndërmjet grupeve vendimmarrëse kanë qenë pengesa kryesore në arritjen e një marrëveshjeje për miratimin e buxhetit. | Rekomandohet intensifikimi i dialogut dhe ndërtimi i një klime bashkëpunuese për të arritur konsensus dhe miratimtë buxhetit sa më parë. |
| 1.1 | | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente. | Të ndërmerren hapa urgjent për rishikimin dhe miratimin e Planit Zhvillimor, në mënyrë që të mos pengohet më tej zhvillimi i komunës. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Objektivat dhe prioritetet zhvillimore të komunës janë komunikuar në mënyrë të hapur me grupet parlamentare dhe qytetarët / me komunitetin e biznesit<br><br>Janë ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm institucionalë, përfshirë Procesin e Hartimit te Planit Zhvillimor Komunal po ashtu janë krijuar e ekipet mbështetëse për sistemin e të dhënave.<br><br>Me gjithë punën intensive, dokumenti aktualisht është vetëm në fazën e draftit dhe ende nuk është miratuar nga kuvendi. | **Në proces!** | 0001. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>0002. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>Shiko te bashkangjitura vendimet! | Bashkëpunimi i vazhdueshëm i Komunës së Gjilanit me komunat fqinje për nevojën e harmonizimit të Planit Zhvillimor Komunal. | PZHK duhet të integrojë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve në zhvillim. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2 | | Mungesa e buxhetit të miratuar për vitin 2025. | Vazhdohet dialogu me të gjitha palët për të arritur konsensus dhe miratim sa më të shpejtë të buxhetit. | Kryetari i Komunës , Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Pas 7 muaj pritje, në fund të muajit shkurt reflektohet dhe u arrit mirëkuptimi për miratimin e buxhetit.<br>Palët ranë dakord që ta votojnë buxhetin, duke zgjidhur një situatë që kishte bllokuar funksionimin e rregullt të komunës. | **E realizuar!**<br><br>(Buxheti është miratuar) | **https://rajonipress.com/tejkalohet-ngerci-ne-kuvendin-e-gjilanit-miratohet-unanimisht-buxheti-per-vitin-2025/**<br><br>**https://gjilan.rks-gov.net/buxheti-komunal/** | Mungesa e konsensusit t kanë vonuar miratimin e buxhetit. | Të forcohet dialogu ndërmjet palëve për të shmangur vonesat e ardhshme në procese vendimmarrëse. |
| 1.3 | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal | Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës | Kryetari i Komunës , Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Kalimi në versionin e ri të webfaqes zyrtare të Komunës së Gjilanit (https://gjilan.rks-gov.net) ka qenë një proces sfidues, për shkak të mungesës së dokumenteve dhe kategorive të rëndësishme.<br><br>Megjithatë, falë bashkëpunimit të ngushtë me ASHI-në dhe kompaninë përgjegjëse, është arritur funksionalizimi i plotë i webfaqes, duke përmirësuar qasjen dhe transparencën për qytetarët. | **E realizuar!**<br><br>Webfaqja është funksionale dhe në përdorim aktiv. | **https://gjilan.rks-gov.net/** | Webfaqja zyrtare tani është e qasshme në adresën https://gjilan.rks-gov.net. | Sot po vazhdohet përditësimi i rregullt i përmbajtjes për të siguruar transparencë dhe informim të plotë për qytetarët. |
| 1.4 | | Përfshirja e vazhdueshme e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike komunale. | Të forcohet dhe institucionalizohet përfshirja e shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave publike komunale. | Kryetari i Komunës<br><br>OJQ-të<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe ajo e Bujqësisë në Komunën e Gjilanit kanë bashkëpunuar me organizatën "OJQ Gruaja Hyjnore " në organizimin e panaireve lokale.<br>Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ka organizuar tre panaire të rëndësishme: më 17 shkurt për Ditën e Pavarësisë, më 7 dhe 8 mars për Ditën e Gruas, dhe më 15 qershor për Ditën e Çlirimit të Gjilanit.<br><br>Po ashtu kemi bashkëpunim edhe me Qendrës për Zhvillimin e Shoqërisë Civile \| konkretishte me Fondacionin Kosovar për | **E realizuar!**<br><br>Panairet janë organizuar me sukses<br><br>**https://kcsfoundation.org/qendra-e-kcsf-se/**<br><br>dhe<br><br>**https://civikos.net/lista-e-anetareve/** | **https://2lonline.com/ne-gjilan-do-te-organizohet-panairi-tradicional-me-moton-nenat-tona/**<br><br>**https://2lonline.com/hapet-panairi-i-punimeve-artizanale-dhe-produkteve-ushqimore-tradicionale/** | Organizimi i panaireve është hasur në sfida lidhur me burimet e kufizuara financiare.<br><br>Komuna e Gjilanit ka një bashkëpunim të mirë me shoqërinë civile, jo | Të rritet mbështetja financiare dhe koordinimi për organizimin më efikas të panaireve të ardhshme. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Shoqëri Civile (KCSF) po ashtu edhe me Platformen CiviKos – Pristhinë | | | vetëm në nivel lokal, por edhe në atë qendror. | |
| 1.5 | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Kuvendi i Gjilanit ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, duke u bazuar në propozimet e Komisionit Konsultativ dhe duke u harmonizuar plotësisht me ligjet në fuqi.<br><br>Ky vendim është dërguar për miratim në Ministrinë e Administratës Publike dhe Lokale (MAPL), duke bërë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të strukturës dhe funksionimit të institucioneve komunale. | **Në proces!**<br><br>Rregullorja është miratuar nga kuvendi dhe është në proces të miratimit nga MAPL. | **https://gjilan.rks-gov.net/news/kuvendaret-e-gjilanit-miratojne-rregulloren-per-organizimin-e-brendshem-dhe-sistematizimin-e-vendeve-te-punes-me-propozimet-e-komisionit-konsultativ-e-ne-harmonizim-me-ligjet-ne-fuqi/** | Procesi i miratimit nga institucione të jashtme nuk e besojmë se mund të sjellë vonesa dhe komplikime administrative. | Të sigurohet komunikim i vazhdueshëm dhe koordinim i ngushtë me institucionet përgjegjëse për në procesin e miratimit. |
| 1.6 | | Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Sipas udhëzimeve për monitorim dhe raportim, Komuna e Gjilanit përgatit raporte për zbatimin e Planit të Integritetit dhe i dorëzon ato Agjencisë së Parandalimit të Korrupsionit.<br><br>Plani i Integritetit për periudhën korrik – dhjetor 2024 është dërguar dhe mund të gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit.<br><br>Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është një proces i vazhdueshëm që kërkon përkushtim për t'u siguruar se masat e parashikuara po ndiqen dhe po arrijnë qëllimet e planit. | **Në vazhdimësi!**<br><br>Plani i Integritetit për periudhën 2024-2026 po raportohet vazhdimisht sipas kërkesave të Agjencisë së Parandalimit të Korrupsionit | **https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-per-Integritet-2024-2026-peridhua-TM3-dhe-TM4.pdf/** | Parashikohet që në vitin 2026 të fillojë formimi i ekipit për përgatitjen e strategjisë për vitet në vijim. | Të vazhdohet monitorimi i rregullt dhe të përgatitet në kohë ekipi për strategjinë e ardhshme. |
| 1.7 | | Mungesa e monitorimit raportimit mbi zbatimin e | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht | Kryetari i Komunës | TM1 dhe TM2 2025 | Pas marrjes së e/mailit nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për monitorimin dhe raportimin e Planit të Integritetit për periudhën janar-qershor 2025, si koordinator kam dërguar menjëherë një njoftim zyrtar (e- | **Në vazhdimësi!** | Vendimi nr. 02/4035 | Koordinimi ndërmjet sektorëve dhe mbledhja e | Të përmirësohet komunikimi dhe |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Planit të Integritetit dhe mungesa e njohurive të stafit të administratës në lidhje me planin e integritetit | zbatimi i Planit të Integritetit | Drejtorit Komunale | | mail) drejtorive dhe sektorëve për sigurimin e të dhënave të nevojshme brenda afatit të caktuar.<br><br>Gjithashtu, kam zhvilluar takim me kryetarin e komunës, i cili është njoftuar për procesin dhe ka premtuar bashkëpunim të plotë në këtë drejtim.<br><br>Në njoftim u kërkua plotësimi i informacionit përkatës në mënyrë që të përgatitet raporti gjashtëmujor dhe të dorëzohet në Agjenci deri më 31 korrik 2025. | Të gjitha veprimet e parapara për monitorimin dhe raportimin janë ndërmarrë brenda afateve të përcaktuara. | Vendimi per planin e integritetit (2).pdf | të dhënave brenda afateve kanë paraqitur sfida të vogla gjatë procesit. | koordinimi ndërmjet sektorëve për të siguruar mbledhje më efikase të të dhënave. |
| 1.8 | | Takime me stafin për t'i informuar për planin e ri të integritetit | Koordinatori i planit të integritetit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Do të organizohen takime informuese me stafin, duke përfshirë edhe takime individuale me secilën nga drejtoritë komunale dhe udhëheqësit e sektorëve, për t'i njohur më mirë me Planin e ri të Integritetit. | **Në proces!**<br>Takimet informuese do te jene gjate muajit korrik 2025 | Raportet e brendshme të komunikimit me drejtori dhe udhëheqësit e sektorëve | Gjatë zbatimit të detyrave nuk janë paraqitur vështirësi. | Nevoja për Trajnime janë të domosdoshme . |
| 1.9 | | Përfshirja e planit të integritetit ne Hartimin e Planit komunal të trajnimeve | Njësia e personelit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Edhe në këtë raport vazhdojë të mbes në nevojën që Agjencia e Parandalimit të Korrupsionit të organizojë takime nëpër komuna me drejtorët dhe udhëheqësit e sektorëve si dhe me zyrtarët komunalë, me qëllim informimin e tyre mbi rëndësinë e Planit të Integritetit dhe masat e parashikuara për parandalimin e korrupsionit. | **Në proces!**<br><br>Njësia e Personelit nuk disponon kapacitetet për të organizuar takime të tilla. | **https://gjilan.rks-gov.net/zyra-per-personel/** | Plani i Integritetit është një proces i panjohur për shumë zyrtarë komunalë. | Nevoja për Trajnime |
| **2.** | POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Sipas Njësia e Personelit komuna e Gjilanit ka këtë numër aktual i te punësuarve : 294 prej tyre 185 meshkuj dhe 109 femra.<br><br>Nga këta nëpunës 268 janë shqiptare, 18 serbe, 6 turq, 1 rom dhe 1 boshnjak .<br><br>Gjate vitit 2024 lirohen 14 pozita te cilat do te plotësohen gjate viti 2025 | **E realizuar!**<br><br>Kuvendi i Gjilanit ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm të vendeve të punës. | Te gjitha publikimet e konkurseve shpallen web faqe te komunës.<br><br>**https://gjilan.rks-gov.net/konkurset-njoftimet/** | Zyra e personelit dhe rregullorja do te trajtoj sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara. | Edhe gjate vitit 2025 parashikohen dalje në pension dhe konkurse për pozitat e lira. |
| 2.1 | | Vlerësimi periodik për rezultatet e punës së zyrtarëve. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Zyrtarët komunal përgatisin raporte javore, mujore dhe një raport vjetor për vlerësimin e rezultateve të punës.<br><br>Drejtoret vlerësojnë raportet dhe japin vlerësime për punën e zyrtarëve në koordinim me Zyrën e Personelit. | **E realizuar!**<br><br>Raportet pasqyrojnë punën individuale të secilit zyrtar. | Dëshmia e raporteve te punës dërguar te | Ekziston sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e punëtorit | Gjithherë në zbatim! |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Drejtori DZHE<br>e-mail raporti i punes.pdf | | |
| 2.2 | | Vendosja e kritereve të vlerësimit sipas Rregullores se klasifikimit. | Kryetari i komunës,<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Kuvendi i Gjilanit ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.<br><br>Ky vendim është dërguar për miratim në Ministrinë e Administratës Publike dhe Lokale (MAPL), duke bërë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të strukturës dhe funksionimit të institucioneve komunale. | **Në proces!**<br><br>Rregullorja është miratuar nga kuvendi dhe është në proces të miratimit nga MAPL. | **https://kryelajmi.com/kuvendaret-e-gjilanit-miratojne-rregulloren-per-organizimin-e-brendshem-dhe-sistematizimin-e-vendeve-te-punes-me-propozimet-e-komisionit-konsultativ-e-ne-harmonizim-me-ligjet-ne-fuqi/** | Procesi i miratimit nga institucione të jashtme nuk e pengon zbatimin | Ne pritje te zbatimit te rregullores |
| 2.3 | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave në përputhje me planin dhe nevojat për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Gjatë muajit qershor është organizuar një trajnim dyditor për Partneritet Publiko Privat (PPP), më 10 dhe 11 qershor 2025, në objektin e IKAP-it (Instituti i Kosovës për Administratë Publike) në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë edhe 4 zyrtarë nga Komuna e Gjilanit. | **E realizuar!**<br><br>Instituti i Kosovës për Administratë Publike ka mbështetur komunat, përfshirë me trajnime të përshtatura sipas nevojave të tyre. | Agjenda e trajnimit - PPP.pdf | Pjesëmarrja e kufizuar për shkak të numrit të kufizuar të vendeve në trajnim. | Bashkëpunimit të vazhdueshëm me IKAP-in. |
| 2.4 | | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Është vlerësuar ndikimi i trajnimit mbi Partneritetin Publiko Privat (PPP), me fokus në rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për të identifikuar dhe menaxhuar projekte të mundshme PPP.<br><br>Trajnimi ka ndihmuar në kuptimin më të mirë të rolit të PPP-së si mjet për përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës lokale. | **E realizuar!**<br><br>Trajnimi është realizuar me sukses dhe ka kontribuar në rritjen e njohurive të zyrtarëve komunalë mbi zbatimin e | Certfiakta - hyrje në PPP.PDF | Mungesa e përvojës praktike në zbatimin e projekteve PPP vështirëson aplikimin e njohurive të fituara nga trajnimi. | Zbatimi efektiv i projekteve PPP në nivel komunal. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | projekteve PPP. | | | |
| 2.5 | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuara | Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Kuvendi i Gjilanit ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.<br><br>Ky vendim është dërguar për miratim në Ministrinë e Administratës Publike dhe Lokale (MAPL),<br><br>Gjatë hartimit të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës është edhe përshkrimi i detyrave të punës për secilin nëpunës. | **Në proces!**<br><br>Rregullorja është miratuar nga kuvendi dhe është në proces të miratimit nga MAPL. | PDF<br>LIGJI NR. 06L-113 organizmi i administ | Gjatë hartimit të rregullores janë hasur vështirësi në harmonizimin e përshkrimeve të detyrave me strukturën ekzistuese. | Rregullore me standardet ligjore dhe praktikat më të mira. |
| 2.6 | | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal. | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Njësia e personelit, përmes e-mailit zyrtar, ka shpërndarë Kodin e Etikës për të gjithë zyrtarët komunalë, duke theksuar rëndësinë e tij në sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë në administratën publike.<br><br>Ky hap përbën një gur themeli në ndërtimin e një kulture të integritetit, në parandalimin e korrupsionit dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. | **E realizuar!**<br><br>Kodi i Etikës është shpërndarë, por zbatimi praktik mbetet i pjesshëm për shkak të mungesës së trajnimeve dhe takimeve për vetëdijesim. | PDF<br>Kodi i Etikes - Komuna e Gjilanit.p | Mungesa e trajnimeve dhe e aktiviteteve informuese pengon zbatimin efektiv. | Nevoja për trajnime! |
| 2.7 | | Mospranimin dhe trajtimin në mënyrë adekuate të informatave sinjalizimeve nga sinjalizuesit /informatorët | Caktimi i zyrtarit përgjegjës për sinjalizim | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij ligji, duke u bazuar në dispozitat e paragrafit 17.<br><br>Këto veprime janë ndërmarrë me qëllim të sigurimit të transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së integritetit institucional. | **E realizuar!**<br><br>sipas Ligjit Nr. 06/L-085, me vendim komunal si dëshmi. | PDF<br>Vendim Sinjalizuesi.pdf | Sfida në zbatimin praktik për shkak të mungesës së përvojës paraprake | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. | PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Edhe pse planifikimi i vijave buxhetore ishte bërë në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve nga Ministria e Financave dhe në harmoni me prioritetet komunale, aprovimi i buxhetit u pengua nga mungesa e konsensusit mes partive politike në Kuvendin Komunal.<br><br>Për të tejkaluar këtë situatë, u organizuan konferenca të jashtëzakonshme dhe seanca urgjente me qëllim arritjen e një marrëveshjeje.<br><br>Pas shtatë muajsh bllokim, në fund të muajit shkurt u arrit dakordimi mes palëve dhe buxheti u miratua, duke mundësuar vazhdimin e funksionimit të rregullt të komunës. | **E realizuar!**<br><br>me vonesë për shkak të mungesës së konsensusit politik. | https://gjilan.rks-gov.net/buxheti-komunal/<br><br>https://rajonipress.com/tejkalohet-ngerci-ne-kuvendin-e-gjilanit-miratohet-unanimisht-buxheti-per-vitin-2025/ | Mungesë bashkëpunimi mes pozitës dhe opozitës, që pengoi miratimin e buxhetit me kohë | Të ndërtohen mekanizma për arritjen e konsensusit në proceset vendimtare |
| 3.1 | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit | Kryetari i komunës dhe drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Kuvendi i Gjilanit ka miratuar Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, e cila është dërguar për miratim në Ministrinë e Administratës Publike dhe Lokale (MAPL).<br><br>Kjo rregullore e re ka hapur rrugën për zhvillimin e takimeve të rregullta dhe konsultimeve para miratimit të buxhetit vjetor.<br><br>Presim që, pas miratimit nga MAPL, ajo të implementohet pa asnjë pengesë, duke kontribuar në përmirësimin e efikasitetit dhe koordinimit ndërmjet organeve komunale në procesin e planifikimit dhe miratimit të buxhetit. | **Në proces!**<br><br>në fazë përfundimi, me miratim të pritshëm nga MAPL. | https://gjilan.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-publik-per-kornizen-afatmesme-buxheote-2026-2028/ | Vonesa në miratimin nga Ministria e Administratës Publike dhe Lokale (MAPL) po pengon zbatimin e plotë të rregullores | |
| 3.2 | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Sipas ligjeve në fuqi, drejtoria e buxhetit ka raportuar për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar.<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/raportet-mujore/<br><br>Ata kane paraqitur raporte financiare periodike (mujore, tremujore dhe vjetore) për shpenzimet, duke siguruar transparencë dhe kontroll mbi përdorimin e fondeve publike. | **E realizuar!**<br><br>Të gjitha shpenzimet janë raportuar në mënyrë të plotë dhe të rregullt, siç dëshmohet nga raportet mujore të publikuara në faqen zyrtare | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-mujore/ | Mungesa e mbështetjes nga opozita dhe komunikimi i dobët midis pozitës dhe opozitës kanë penguar | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | të Komunës së Gjilanit | | miratimin e buxhetit. | |
| 3.3 | | Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Është i nevojshëm një koordinim i ngushtë ndërmjet drejtorie për të siguruar se shpenzimet janë të arsyeshme dhe brenda kuadrit ligjor.<br><br>Plani siguron alokimin e fondeve në mënyrë të drejtë dhe transparente. | **E realizuar!**<br><br>Regjistrimi i planifikimit të planit të shpenzimeve regjistrohet në sistemin e SIMFK çdo fillim vit. | Raport Financair - janar - maj 2025.pdf | | |
| 3.4 | | Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës | Njësia për informim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Vetëm për Buxhetimin me Pjesëmarrje, gjatë këtij gjashtëmujori 2025, Komuna ka realizuar 35 aktivitete, dhe që të gjitha janë publikuar në webfaqen e Komunës. Komuna ka realizuar me sukses dhe ka publikuar në webfaqe, profilin virtual në facebook dhe në mediat lokale, tërë procesin e dëgjimeve buxhetore.<br><br>Me 15 janar 2025 ASHI, nëpërmjet kompanisë përgjegjëse, ka lansuar webfaqet e reja, por ka lënë shumë paqartësi dhe nuk e ka bërë rivendosjen e dokumenteve sipas kërkesave të Komunës së Gjilanit, përkundër premtimeve. | **Në proces!**<br><br>Mirëmbajtja e serverit të ueb-faqeve është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore të Informacionit. | https://gjilan.rks-gov.net/news/komuna-e-gjilanit-do-te-organizoje-degjimet-buxhetore-per-kab-2025-2027-kalendari/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/buxhetimi-me-pjesemarrje-lajme/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/ | Raporti financiar i bashkangjitur për periudhën janar–maj 2025 përfshin të gjitha planifikimet mbi të hyrat, shpenzimet dhe paraqet një pasqyrë të plotë të realizimit buxhetor | |
| 3.5 | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e | Kryetari i komunës dhe Drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Për periudhën raportuese Janar-Qershor 2025 për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konfrom Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve Komuna e Gjilanit ka ndare gjithsej 360 000 €.<br><br>Lista-paraprake-e-OJQ-ve-perfituese-sip | **E realizuar!**<br><br>Sipas ligjeve në fuqi, drejtori i buxhetit ka raportuar për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar. | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Lista-paraprake-e-OJQ-ve-perfituese-sipas-Thirrjes-Publike-te-DShMS-se-1.pdf/ | Akterët institucionalë dhe OJQ-të nuk e kanë të kufizuar efektivitetin e monitorimit të zbatimit të buxhetit. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | | | | Lista-perfundimtare -e-projekt-propozim | | | | |
| 3.6 | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Regjistri i brendshëm i aseteve përditësohet çdo fund vit \| vendimi numër 4015/ i datës 11/09/24<br><br>SIMFK - Raportet e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit.<br><br>Ne muajin tetor do te formohet komisioni qe do te ri-verifikoj inventarizimin e secilit aset | **E realizuar!**<br><br>Ekzistojnë edhe komisioni komunal dhe komisionet ne për drejtori | Vendimi per Inventarizim I.pdf<br><br>Vendimi per Invertarizim - DZHE.p | Komisionet e inventarizimit nuk kanë hasur në vështirësi. | |
| 3.7 | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Pas përfundimit të procesit të inventarizimit dhe regjistrimit të pasurisë jo kapitale, Kryetari ka autorizuar përmes vendimit, një zyrtare për përditësimin e regjistrit në sistemin elektronik e-pasuria. | **E realizuar!**<br><br>Përditësimi në sistemin elektronik e-pasuria është duke u realizuar sipas autorizimit, | Vendimi Nr. 02/742 i datës 04.06.2025<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/vendimet-e-kryetarit/ | Nuk ka | Të mirëmbahen në përditësimi i te dhënave në sistemin e pasurisë jo kapitale e-pasuria. |
| 4. | RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jo-zyrtare | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale<br><br>Zyra e IT | TM1 dhe TM2 2025 | Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI) është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe sigurimin e rrjetit të internetit të institucioneve shtetërore, duke garantuar që ky rrjet të jetë i sigurt, efikas dhe i besueshëm.<br><br>Zyra Komunale e e IT zbatohn në vazhdimësi procedurat e brendshme të zhvilluara dhe miratuara nga Ministria e Linjës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative. | **E realizuar!**<br><br>https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy | ASHI- posta elektronike zyrtare1.<br><br>Nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit kemi shume e-mail paralajmërues | Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme në nivel lokal nganjëherë vështirëson zbatimin e plotë të udhëzimeve të nivelit qendror. | |
| 4.1 | | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Gjatë periudhës janar–qershor 2025 nuk është raportuar ndonjë ndryshim ose përmirësim i veçantë në menaxhimin e sigurisë së sistemeve nga Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI). | **E realizuar!**<br><br>mbetet konstant, | https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy/ | Sfidat e sigurisë në një mjedis teknologjik me ndryshime të shpejta. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | | Zyra e IT | | ASHI- posta elektronike zyrtare2. | | | | |
| 4.2 | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit. | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit ka të themeluar sistemin e saj të arkivimit, i cili funksionon në përputhje me kornizën ligjore dhe praktikat administrative. Arkiva kryesore komunale dhe zyrtari përgjegjës për arkivë veprojnë brenda strukturës së Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.<br><br>Përveç arkivës qendrore, në secilën drejtori komunale është i emëruar nga një zyrtar përgjegjës për arkivin dhe ruajtjen e dokumentacionit administrativ.<br><br>Vlen të theksohet se Komuna e Gjilanit ka draftuar **Rregulloren për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre**, e cila është aktualisht në fazën e shqyrtimit dhe finalizimit. | **Në proces!**<br><br>Kjo nismë përforcon angazhimin e komunës në drejtim të përmirësimit të transparencës, menaxhimit të dokumentacionit dhe ruajtjes së trashëgimisë administrative për gjeneratat e ardhshme. | https://gjilan.rks-gov.net/drejtoria-per-administrate-e-pergjithshme/ | Rregulloret dhe udhëzimet janë në fazë draftimi dhe jo të miratuara përfundimisht. | |
| | | | | | | | | | | |
| **Të dhënat e Planit të Integritetit** | | | | | | **Raportimi i zbatimit** | | | | |
| 1. | AUDITIMI I BRENDSHËM | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM1 dhe TM2 2025 | Plani strategjik i auditimit, Plani vjetor i auditimit dhe planet individuale për kryerjen e auditimeve.<br><br>Për çdo auditim të brendshëm hartohet formulari standard nr. 1017 plani i auditimit.<br><br>Pas kësaj zhvillohen auditimet dhe plotësohen formularët nr. 3002 dhe raporti final. | **E realizuar!**<br><br>E gjitha në përputhje me prioritetet e rrezikut të identifikuara. | https://gjilan.rks-gov.net/plani-i-veprimit/<br><br>Raporti Vjetor i NjAB per vitin 2024.p<br><br>Për vitin 2025 do ta sjellim ne fund te vitit | Mungesa e burimeve të mjaftueshme | . Bashkëpunim më i mirë nga strukturat përgjegjëse për zbatimin e planit. |
| 1.1 | | Të sigurohen auditime rast pas rasti për të | Kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive | Kryetari i Komunës | TM1 dhe TM2 2025 | Zyra Komunale e Auditimit në Komunën e Gjilanit ka realizuar auditimet e brendshme dhe ka monitoruar shpenzimet publike. | **E realizuar!**<br><br>Procesi i auditimit është zbatuar sipas | https://zka-rks.org/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e- | Mungesë të kapaciteteve profesionale. | Të rritet aftësimi profesional i stafit të |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | vërtetuar të gjeturat gjatë inspektimeve | | Drejtorit Komunal e | | Ndërsa Komisioni Komunal i Auditimit ka mbikëqyrur procesin dhe ka kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. | planifikimit, me përfshirje të rregullt të Komisionit Komunal të Auditimit. | auditimit-te-brendshem/ | | përfshirë në auditim. |
| 1.2 | | Mungesa e mbikëqyrjes adekuate, profesionale mbi zbatimin e rekomandimeve të auditorit | Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Njësia e Auditimit te Brendshëm ne Gjilan : përgatit : Raportin vjetor lidhur me aktivitetet e auditimit të brendshëm në Subjektin e Sektorit Publik \| periudhën prej 01.01. 2024 deri 31.12. 2024 | **E realizuar!**<br><br>Raporti vjetor është përgatitur dhe dorëzuar brenda afatit | https://zka-rks.org/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/ | Vështirësi janë hasur në grumbullimin e të dhënave. | Përgatitja e raportit cilësor dhe në kohë. |
| 1.4 | | Mungesa e koordinimi ndërmjet Njësisë së AB, Komisionit të Auditimit Kryetarit dhe njësive komunale | Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Pas pranimit të rekomandimeve nga auditimi, menaxhmentet e drejtorive përkatëse kanë hartuar dhe dorëzuar Planin e Veprimit përmes formularit nr. 3003, duke u koordinuar me Zyrën e Auditimit përmes komunikimit formal, takimeve verbale dhe raporteve standarde të auditimit. | **Në proces!**<br><br>Plani i veprimit është përgatitur nga menaxhmentet e drejtorive. | https://zka-rks.org/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njesia-e-auditimit-te-brendshem/ | Janë evidentuar vonesa në kthimin e formularëv. | Dorëzimin e planeve të veprimit nga njësitë audituese. |
| 2. | PROKURIMI PUBLIK | | Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Për të siguruar përgatitjen cilësore të specifikimeve të tenderit dhe respektimin e parimeve të mos-diskriminimit, Zyra e Prokurimit e Komunës ka ndërmarrë masa konkrete në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP), sidomos me dispozitat e neneve 7, 68 dhe 69.<br><br>Specifikimet teknike hartohen në mënyrë neutrale, duke shmangur çdo referencë diskriminuese apo preferuese, në përputhje me nenin 7 të LPP-së që përcakton parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit për operatorët ekonomikë. Gjithashtu, zbatohet neni 68 që rregullon qartë kriteret për përgatitjen e specifikimeve teknike, si dhe neni 69 që ndalon diskriminimin përmes përshkrimeve teknike apo markave specifike. | **E realizuar!**<br><br>Me praktika të konsoliduara në hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave të LPP-së dhe mbikëqyrje të rregullt nga Zyra e Prokurimit. | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate/ | Paraqiten në interpretimin e saktë të kërkesave teknike nga njësitë kërkuese | . |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | |
| 2.1 | | Përgatitje joefikase e specifikimeve të tenderit | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna ka forcuar gjithashtu transparencën dhe mbikëqyrjen në të gjitha fazat e prokurimit publik.<br><br>Tërë dokumentacioni i tenderëve — nga njoftimi i kontratës, dosja e tenderit, procesverbalet, vendimet e vlerësimit dhe dhënia e kontratës — publikohet në platformën zyrtare të e-prokurimit të KRPP-së, duke siguruar qasje të barabartë dhe transparente për të gjithë palët e interesuara.<br><br>Komunikimi me operatorët ekonomikë dhe palët tjera relevante bëhet ekskluzivisht përmes platformës elektronike të prokurimit, në përputhje me udhëzimet e KRPP-së dhe standardet e parapara në aktet nënligjore. | E realizuar!<br><br>Transparenca dhe publikimi i të gjitha fazave të prokurimit në platformën e KRPP-së janë të institucionalizuara dhe zbatohen në mënyrë të rregullt. | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate// | Mungesë njohurish për përdorimin e platformës elektronike nga Operatoret Ekonomik, | |
| 2.2 | | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik dhe njësitë kërkuese | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me KRPP-në dhe institucionet tjera relevante, ka angazhuar stafin e Zyrës së Prokurimit dhe njësive kërkuese në trajnime dhe punëtori të specializuara për prokurimin publik. Personeli është trajnuar në përputhje me programet zyrtare të KRPP-së, duke përfshirë modulët për përgatitjen e dosjes së tenderit, hartimin e specifikimeve teknike, menaxhimin e kontratave dhe përdorimin e platformës së e-prokurimit.<br><br>Një pjesë e stafit është pajisur me çertifikata profesionale të avancuara për prokurim, siç evidentohet në listat publike të KRPP-së Përveç kësaj, Komuna ka ndjekur praktikat më të mira në organizimin e trajnimeve të brendshme dhe pjesëmarrjen aktive në seminare të organizuara nga donatorët ndërkombëtarë dhe institucione vendore, me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe sigurimin e përputhshmërisë me Ligjin për Prokurimin Publik. | E realizuar!<br><br>Pjesa më e madhe e stafit te Zyrës se prokurimit ne Gjilan është certifikuar sipas standardeve të KRPP-së. | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=277/ | Ngarkesa e punës ka kufizuar pjesëmarrjen e rregullt në trajnimet. | |
| 2.3 | | Mos transparenca dhe mbikëqyrja | Publikimi i Planit të Prokurimit | Kryetari i Komunës | TM1 dhe TM2 2025 | Ekziston transparencë e mjaftueshme në procesin e prokurimit publik, pasi të gjitha informacionet përkatëse janë të publikuara në | E realizuar!<br><br>Të dhëna janë të garantuara | https://oshp.rks-gov.net/ | Jo të gjithë qytetarët kanë njohuri të | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e pa mjaftueshme e prokurimit publik | në ueb faqen e komunës | Drejtorit Komunal e | | webfaqen : https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=205<br><br>Ankesat janë të aksesueshme përmes Organit Shqyrtues të Prokurimit : https://oshp.rks-gov.net/<br><br>Ky proces siguron llogaridhënie dhe mundësi për monitorim nga qytetarët dhe palët e interesuara. | përmes platformave zyrtare dhe zbatohen në praktikë në mënyrë të qëndrueshme**.** | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=205/<br><br>Planifikimi-i-Prokurimit-Perfundimtar-20 | mjaftueshme per këto platforma! | |
| 2.4 | | Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikim in me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit | Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM1 dhe TM2 2025 | Në mbështetje të neneve 12, par. 2, 68, par. 4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28.06.2008), nenit 42 par. 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, si dhe Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit nxjerrë këtë: RREGULLORE (KGJ) NR. 1/2025 PËR PËR TRANSPARENCË E KOMUNËS SË GJILANIT<br><br>Kjo Rregullore përcakton rregullat që sigurojnë transparencë të punës së organeve komunale, kryetarit të komunës, drejtorive, kuvendit, trupave të kuvendit si dhe mekanizmave të tjerë ligjor, si dhe rregullat, parimet dhe format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset vendimmarrëse | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Rregullorja-per-transparence-komunale-2025.pdf/ | | |
| 3. | MENAXHIMI I KONTRATAVE PUBLIKE | Mungesa e stafit profesional për menaxhimin kontratave | Menaxhimi i kontratave nga zyrtarët me kompetencë profesionale | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 dhe TM2 2025 | Njësia e Prokurimit Publik funksionon me staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar, i cili ka kompetencë profesionale për menaxhimin e kontratave në përputhje me legjislacionin përkatës.<br>Për çdo aktivitet prokurimi, janë ndërmarrë veprime të rregullta për mbikëqyrje dhe zbatim të kontratave, duke siguruar transparencë dhe efikasitet në menaxhim. | **E realizuar!**<br><br>Niveli i realizimit është i mirë, pasi Njësia e Prokurimit Publik është funksionale dhe e pajisur me staf të kualifikuar për menaxhimin e kontratave. | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-12/ | Kur kërkohet ekspertizë më e specializuar për kontrata komplekse ose të ndërlikuara | |
| 3.1 | | | Trajnimi i zyrtarëve për | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 dhe TM2 | KRPP (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik) ka ofruar trajnime për modulin e menaxhimit të kontratave po ashtu edhe IKAP-it | **E realizuar!** | https://krpp.rks-gov.net/ | Vështirësitë qëndrojnë në | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | menaxhimin e kontratave | | 2025 | (Instituti i Kosovës për Administratë Publike) në Prishtinë ka organizuar trjnime te tilla.<br><br>KRPP dhe IKAP janë dy mekanizma kyç të ndërlidhur që ofrojnë trajnime të specializuara për prokurim publik dhe menaxhim të kontratave, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë. | Është i kënaqshëm, pasi janë zhvilluar trajnime të vazhdueshme për zyrtarët komunalë në menaxhimin e kontratave | [https://ikap.rks-gov.net/m](https://ikap.rks-gov.net/m) | sigurimin e pjesëmarrjes së rregullt | |
| 3.2 | | | Kompensimi për personat e përfshirë në menaxhimin e kontratave | Njësia e Prokurimit Publik | TM1 dhe TM2 2025 | Deri më tani, përfshirë periudhën janar–qershor 2025, nuk është zbatuar asnjë formë kompensimi për zyrtarët që kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara, përfshirë edhe ata të angazhuar në menaxhimin e kontratave. | **Në proces!**<br><br>Niveli i realizimit është i ulët | [https://gjilan.rks-gov.net/raportet-13/](https://gjilan.rks-gov.net/raportet-13/) | Vështirësitë lidhen me mungesën e rregulloreve specifike dhe mjeteve buxhetore | |
| .4. | ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA | Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal | Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 dhe TM2 2025 | Bllokada politike edhe sot po dëmton zhvillimin ekonomik dhe qytetarët e Gjilanit.<br>Iniciativat e propozuara nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, duke mos lejuar përfshirjen në rend dite të tri çështjeve me rëndësi:<br>1. Miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024–2031.<br>2. Faljen e borxheve të bizneseve për taksën komunale (2000–2019) në vlerë prej mbi 1,760,000 €<br>3. Lirimin nga taksa komunale per biznese për vitin 2025,<br><br>Këto propozime, të mbështetura paraprakisht nga Komiteti për Politikë dhe Financa, po bllokohen pa arsye të qarta nga opozita, duke dëmtuar drejtpërdrejt qytetarët, bizneset dhe vetë zhvillimin ekonomik të komunës.<br>Kjo sjellje pengon projektet, punësimin dhe investimet, duke vënë interesat politike mbi nevojat e qytetarëve. I bëhet apel opozitës që të reflektojë dhe të japë mbështetjen e nevojshme për miratimin e këtyre iniciativave jetike për komunën. | **Në proces!**<br><br>për shkak të bllokadës së vazhdueshme politike nga opozita, e cila ka pamundësuar miratimin e iniciativave kyçe për zhvillimin ekonomik të komunës. | [https://www.facebook.com/share/p/15ieqyxFVk/](https://www.facebook.com/share/p/15ieqyxFVk/)<br><br>Dokumenti:<br><br>DRAFT - Strategjia per Zhvillim Ekonom<br><br>[https://rajonipress.com/bllokada-politike-pengon-zhvillimin-ekonomik-dhe-demton-mireqenien-e-qytetareve-dhe-bizneseve-te-gjilanit/](https://rajonipress.com/bllokada-politike-pengon-zhvillimin-ekonomik-dhe-demton-mireqenien-e-qytetareve-dhe-bizneseve-te-gjilanit/) | Vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e konsensusit politik në Kuvendin Komunal, që pengon miratimin e vendimeve strategjike për zhvillim ekonomik. | Rekomandohet që të intensifikohet dialogu ndërmjet palëve politike për të siguruar miratimin e iniciativave që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | | | Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës | | TM1 dhe TM2 2025 | Bazuar në situatën e përshkruar më lart, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të Komunës së Gjilanit do të duhej të fokusohej në këto drejtime kryesore:<br>1. krijimi i mekanizmave për bashkëpunim ndërpartiak për miratimin e dokumenteve strategjike dhe vendimeve të rëndësishme.<br>2. mbështetja direkte për bizneset lokale – përmes lehtësirave fiskale ׀ si falja e borxheve dhe lirimi nga taksat komunale, për të nxitur aktivitetin ekonomik.<br>3. miratimi dhe zbatimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024–2031 – si një dokument themelor për orientimin afatgjatë të zhvillimit.<br>4. krijimi i kushteve për investime private dhe publike – duke siguruar stabilitet institucional dhe klimë të favorshme për investitorët.<br>5. zhvillimi i infrastrukturës dhe projekteve punëkrijuese – me fokus në rritjen e punësimit dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. | **Në proces!**<br><br>Në thelb, prioriteti kryesor duhet të jetë tejkalimi i bllokadave politike dhe funksionalizimi i plotë i Kuvendit Komunal si mekanizëm vendimmarrës për zhvillim | **https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/10/Draft-Strategjia-per-Zhvillim-Ekonomik-Lokal-e-Komunes-se-Gjilanit.pdf/**<br><br>**https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Komuna-e-Gjilanit-Profili-Ekonomik-2024-1.pdf/** | Kapërcimi i bllokadave politike dhe sigurimi i funksionimit efektiv të Kuvendit Komunal si organ vendimmarrës për avancimin e zhvillimit ekonomik. | |
| 4.2 | | Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të paqarta dhe jo-transparente. | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimin dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal. | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit ka ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar qartësi dhe transparencë në përcaktimin e qëllimeve dhe prioriteteve të zhvillimit ekonomik, duke përfshirë pjesëmarrjen aktive të të gjitha palëve relevante në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike.<br><br>Çdo dokument hartohet në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe përkthehet edhe në gjuhën serbe, për të siguruar qasje të barabartë për të gjitha komunitetet.<br><br>Po ashtu, Zyra për Kthim dhe Komunitete është e përfshirë në të gjitha proceset zhvillimore, duke garantuar përfaqësim dhe përfshirje të komuniteteve jo-shumicë në planifikimet ekonomike të komunës. | **E realizuar!**<br><br>Niveli i realizimit është i lartë, pasi janë siguruar transparenca ne komunikim | VODIČ ZA PRIMENU I.pdf<br><br>VODIČ ZA PRIMENU lot 2.pdf<br><br>VODIČ ZA PRIMENU lot 1.pdf | Sigurimin e pjesëmarrjes aktive gjatë gjithë procesit të hartimit dhe zbatimit të prioriteteve. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.3 | | Kritere jo të qarta dhe transparencë të pa mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 dhe TM2 2025 | Gjatë kësaj periudhe, është përmbyllur me sukses projekti “Fondi për Subvencionimin e Bizneseve Start-UP dhe Bizneseve të Grave Ndërmarrëse 2024”, ndërsa aktualisht jemi në fazën e zbatimit të programit për vitin 2025.<br><br>Ndarja e subvencioneve bëhet në përputhje me Rregulloren komunale për subvencione, ndërsa Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ka organizuar një dëgjim publik, ku morën pjesë një numër i madh qytetarësh – me pjesëmarrje dominuese të të rinjve dhe grave. Ky interesim i lartë ka rezultuar me mbi 180 aplikime për përfitim nga fondi.<br><br>Komuna e Gjilanit do të vazhdojë me këtë program edhe në vitet në vijim, duke e konsideruar atë si një politikë të rëndësishme për mbështetjen e ndërmarrësisë lokale dhe fuqizimin ekonomik të grave dhe të rinjve. | Lista-perfundimt -e-aplikacioneve-<br><br>UDHËZUESI PËR APLIKIM.pdf | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Lista-perfundimtare-e-aplikacioneve-perfituese-per-Subvencionet-%E2%80%93-Bizneset-Start-Up-dhe-bizneset-ekzistuese-te-grave-2025.pdf/ | Vështirësitë kryesore lidhen me buxhetin e kufizuar për të përmbushur numrin e lartë të aplikimeve dhe pritshmërive nga qytetarët. | |
| 4.4 | | | Përfshirja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik | TM1 dhe TM2 2025 | Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me me Drejtorinë e Bujqësisë dhe OJQ “Gruaja Hyjnore” ka organizuar tri panaire në Komunën e Gjilanit:<br><br>Panairi “Festo Tradicionalisht “ për nder të 16 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës<br><br>- Panairi “Nënat Tona” \| për nder të festave 7 Marsi - Dita e Mësuesit dhe 8 Marsi - Dita e Gruas<br><br>Panairi 15 qershor për nderë të Ditës së Çlirimit të Gjilanit. | **E realizuar!**<br><br>Niveli i realizimit është i lartë, me organizimin e suksesshëm të tri panaireve tradicionale që promovojnë vlerat kulturore dhe zhvillimin ekonomik lokal. | https://www.facebook.com/share/p/16NxN4puvk/<br><br>https://www.facebook.com/share/p/16s4AJRrDT/<br><br>https://www.facebook.com/share/p/1B5K2KWUPa/ | Vështirësitë lidhen me sigurimin e mjeteve financiare dhe përfshirjen e sa më shumë bizneseve lokale në organizimin e këtyre panaireve tradicionale. | |
| 4.5 | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Zhvillim | TM1 dhe TM2 2025 | Janë organizuar trajnime të specializuara mbi Partneritetin Publiko-Privat (PPP), me qëllim rritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e projekteve potenciale PPP. | **E realizuar!**<br><br>Trajnimi është realizuar me sukses dhe ka kontribuar në rritjen e | Certfiakta - hyrje në PPP.PDF<br><br>Po ashtu :<br>https://gjilan.rks-gov.net/news/drej | Mungesa e përvojës praktike në zbatimin e projekteve PPP vështirëson | Zbatimi efektiv i projekteve PPP në nivel komunal. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Ekonomi k | | Këto trajnime kanë ndihmuar në thellimin e kuptimit të rolit të PPP-së si një mjet strategjik për përmirësimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e infrastrukturës lokale, duke përgatitur staf më të aftë për zbatimin e projekteve të zhvillimit ekonomik në komunë. | njohurive të zyrtarëve komunalë mbi zbatimin e projekteve PPP. | **toria-e-bujqesise-mbajti-trajnimin-me-fermeret-e-komunes-se-gjilanit/** | aplikimin e njohurive të fituara nga trajnimi. | |
| 4.6 | | Mbikëqyrja jo efikase mbi zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal | Kryetari i Komunës<br>,<br>Zyrtari Kryesor Financiar<br>,<br>Kuvendi Komunal | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna ka vendosur mekanizma të rregullt për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal, duke përfshirë raportime periodike dhe takime koordinuese ndërmjet departamenteve përkatëse.<br>Përmes këtyre veprimeve, synohet të sigurohet transparenca, efektiviteti dhe përparimi i qëndrueshëm në realizimin e projekteve dhe politikave ekonomike. | **E realizuar!**<br><br>Mekanizmat e mbikëqyrjes dhe raportimit funksionojnë rregullisht dhe ndihmojnë në përmirësimin e zbatimit të aktiviteteve zhvillimore. | **https://gjilan.rks-gov.net/raportet-planet-10/**<br><br>Raporti \| Janar-Qershor 2025 | Gjatë zbatimit të aktiviteteve nuk janë hasur vështirësi të konsiderue shme, | |
| 4.7 | | Mos përfillja e dokumente ve strategjike gjatë planifikimit vjetor buxhetor dhe kornizës afatmesme buxhetore | Shqyrtimi i përputhshm ërisë së buxhetit vjetor me dokumetet strategjike komunale | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Urbanizë m dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Bllokada politike në Kuvendin Komunal pengon miratimin dhe përfshirjen e dokumenteve strategjike kyçe, si Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024–2031, në procesin e planifikimit vjetor dhe kornizës afatmesme buxhetore.<br><br>Kjo çon në mungesë përputhshmërie mes buxhetit vjetor dhe objektivave strategjike komunale, duke dëmtuar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Gjilanit.<br><br>Pa miratimin e këtyre dokumenteve, nuk mund të garantohen investimet dhe projektet e nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike. | **E realizuar!**<br><br>Niveli i realizimit është i ulët për shkak të bllokadës politike që pengon miratimin e dokumenteve strategjike dhe integrimin e tyre në planifikimin buxhetor. | **https://gjilan.rks-gov.net/raportet-planet-10/** | Mungesa e dialogut konstruktiv politik | |
| 5. | PLANIFIKIMI URBAN DHE RURAL | Mangësi në rregullat ivën e brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet | Drejtoria për Urbanizë m dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit ka miratuar procedura të brendshme që përcaktojnë kritere të qarta për planifikimin urban dhe rural, duke reduktuar subjektivitetin dhe vendimet të bazuara në kontakte personale; vendimet marrin vetëm zyrtarë profesionalë. | **E realizuar!**<br><br>Reduktim të rreziqeve dhe transparencë vendimmarrjej e. | **https://gjilan.rks-gov.net/plani-zhvillimor-komunal/**<br>0002. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji | Të punohet per te shmangur gabimet formale. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive | Njësia Planifkimit | | Procedurat janë hartuar dhe miratuar, dhe janë duke aplikuar në praktikë, duke garantuar përmbushjen e objektivave.<br><br>Zbatimi i kërkesave të reja kërkon trajnim të mëtejshëm të stafit. | | 0001. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>0003. Vendimi per Trajtimin Ndërtimeve | | |
| 5.1 | | Zbatim jo i plotë i rregullativës së brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullatives së brendshme | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit<br><br>Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, është njëra nga katër komunat përfituese të projektit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës "Skanimi i dokumenteve të arkivuara kadastrale".<br><br>Do të skanohen rreth 270 mijë dokumente të formateve të ndryshme, duke siguruar ruajtjen dhe qasjen më të lehtë në të dhënat kadastrale, të cilat do të mundësojnë ruajtjen digjitale dhe lehtësimin e qasjes në dokumente kadastrale, duke sjellë përfitime të mëdha për qytetarët dhe institucionet në marrjen dhe ofrimin e shërbimeve.<br>Rëndësia e skanimit dhe ruajtjes digjitale janë: Mbrojtje më e mirë e dokumenteve nga dëmtimi apo humbja. Qasje më e shpejtë dhe e lehtë në të dhënat kadastrale. Përmirësim i shërbimeve për qytetarët dhe administratën, ky është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit dhe digjitalizimit të shërbimeve publike, duke e bërë sistemin kadastral më efikas, transparent dhe të sigurt. | **E realizuar!**<br><br>Projekti është në fazë implementimi dhe konsiderohet i realizueshëm, me mbështetje institucionale dhe kapacitete të mjaftueshme teknike. | https://telegrafi.com/digjitalizimi-dokumenteve-kadastrale-ne-gjilan-salihu-lehtesi-per-qytetaret-ne-qasjen-ndaj-prones<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/salihu-lajm-i-rendesishem-per-qytetaret-e-gjilanit-do-te-skanohen-rreth-270-mije-dokumente | Mungesa e stafit të mjaftueshëm teknik dhe sfidat me dokumentet e dëmtuara mund të ngadalësoj në procesin e skanimit. | |
| 5.2 | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si GIZ dhe institucionet akademike, ka organizuar trajnime dhe ndërtim kapacitar për stafin e planifikimit urban/rural. Përmes Memorandumit të Bashkëpunimit me GIZ, është forcuar përdorimi i GIS dhe janë ofruar trajnimet mbi hartat zonale dhe menaxhimin hapësinor, duke ngritur kapacitetet profesionale të stafit lokal. | **E realizuar!**<br><br>Janë mbajtur punëtori dhe seminare për urbanizëm, por pjesëmarrja është ende jo universale dhe mbetet në fazë zgjerimi. | https://gjilan.rks-gov.net/en/urbanizem-planifikim-dhe-mbrojtje-e-mjedisit/<br><br>https://www.facebook.com/p/Drejtoria-p%C3%ABr-Urbaniz%C3%ABm-Planifikim-dhe-Mbrojtje-t%C3%AB- | Kërkon angazhim dhe përfshirje më të gjerë për të arritur përgatitje të njëtrajtshme. | Te sigurohen trajnimet e specializuara per Planin Zhvillimor Komunal |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Mjedisit-Komuna-Gjilan-61556307374904/ | | |
| 5.3 | | Kualifikimi i pamjaftues hëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Në Korrik 2025 është publikuar raporti i punës së Drejtorisë për periudhen Janar-Qershor 2025 duke përfshirë analizë të statusit të dokumenteve zhvillimore dhe sistemeve rregulluese për urbanizëm. Është krijuar dhe përditësuar interna për planifikimin urban dhe rural në pajtim me kërkesat ligjore, duke përcaktuar kritere të qarta për përzgjedhjen dhe menaxhimin e zonave, me qëllim reduktimin e vendimeve subjektive<br><br>Stafi profesional i angazhuar në përgatitjen dhe ndryshimin e Planit Zhvillimor Komunal për periudhën 2025–2033 ka zhvilluar punë konsulente dhe draft-raporte në koordinim me institucione dhe me publikun, duke organizuar gjithashtu diskutime publike dhe shqyrtime të dokumenteve bazë. | **E realizuar!**<br><br>Është siguruar aplikim të rregullativës së brendshme dhe përditësim të kualifikimeve profesionale. | https://www.facebook.com/p/Drejtoria-p%C3%ABr-Urbaniz%C3%ABm-Planifikim-dhe-Mbrojtje-t%C3%AB-Mjedisit-Komuna-Gjilan-61556307374904/ | Nevojiten raportime zyrtare për çdo tremujor. | |
| 5.4 | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Instituti i Kosovës për Administratë Publike ofron trajnime për nëpunësit civilë në nivel lokal, përfshirë fushën e planifikimit urban dhe rural, duke mbështetur zhvillimin profesional dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit komunal. | **E realizuar!**<br><br>Stafi janë përfshirë në trajnime për planifikim urban dhe rural përmes IKAP-it. | https://ikap.rks-gov.net/ | Mungesa e burimeve dhe ngarkesës së punës. | Të rritet pjesëmarrja në trajnime përmes planifikimit më të mirë. |
| 6. | STANDARDET E NDËRTIMIT DHE KONTROLLI | Mungesa e kontrolleve konsistente gjatë ndërtimit dhe në vend punishte | Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje. | Drejtoria e Inspekcionit dhe<br><br>Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | TM1 dhe TM2 2025 | Drejtoria për Inspeksion ka përqendruar aktivitetet e saj në intensifikimin e kontrolleve në vendet e ndërtimit, duke përdorur inspektorët e fushave të specializuara për të monitoruar respektimin e ligjeve, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve, me qëllim ndalimin e ndërtimeve pa leje në fazat e hershme. | **E realizuar!**<br><br>Janë intensifikuar dhe monitorimi i respektimit të ligjeve. | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-e-kryetarit/<br><br>Referoju faqes se raportit nr.36 deri ne faqe 39<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/drejtoria-e-inspeksionit/ | Mungesa e burimeve të mjaftuesh me njerëzore. | Rritja e numrit të inspektorëve |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.1 | | Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin e ndërtimeve | Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Drejtoria për Urbanizëm dhe Drejtoria e Inspekcionit | TM1 dhe TM2 2025 | Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Gjilanit ka kuadro të mjaftueshëm dhe adekuat profesional për planifikim urban dhe rural, disa me mbi 20 vite përvojë dhe të licencuar nga MMPH.<br><br>Ekziston Shoqata e Arkitektëve të Gjilanit që shërben si urë komunikimi e përhershme mes Departamentit për Inspektim dhe Drejtorisë së Urbanizmit.<br><br>**https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=7&subType=9** | **Në proces!**<br><br>Të ruhet dhe përkrahet zhvillimi profesional i stafit ekzistues për të siguruar vazhdimësi. | **https://2lonline.com/mbahet-kuvendi-i-pare-zgjedhor-i-shoqates-se-inxhiniereve-dhe-arkitekteve-te-gjilanit** | Të zgjerohet bashkëpunimi me aktorë të tjerë profesional ë dhe shoqëri civile për planifikim gjithëpërfshirës | |
| 6.2 | | | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | Njësia e Burimeve Njerëzore | TM1 dhe TM2 2025 | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe lokale, ofron trajnime të strukturuara dhe cilësore për zhvillimin kapaciteteve të stafit në fushat e planifikimit urban dhe rural.<br>Përmes këtij bashkëpunimi: | **Në proces!**<br><br>Fokusi është në ngritjen e aftësive të nevojshme për zyrtarët komunalë dhe drejtuesit teknikë në zbatim te ligjit | **https://ikap.rks-gov.net/trainings**<br><br>**smt-ikap.rks-gov.nete-prokurimi.rks-gov.netgzk.rks-gov.net** | Shpesh, personat e trajnuar nuk mbeten afatgjatë në institucione për shkak të migrimit profesional. | |
| 7. | INSPEKTIMET | Mungesa e planifikimit të duhur të inspektimeve | Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut. | Drejtoria e Inspeksionit<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore | TM1 dhe TM2 2025 | Drejtoria e Inspeksionit gjate periudhës janar – qershor 2025 por edhe sot ne vazhdimësi ka punuar ne shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve.<br><br>Inspektorët kanë dalë në terren për të konfirmuar mashtrimet që po bëhen ndaj konsumatorëve, që ndryshe i shohin çmimet në rafte e obligohen të paguajnë ndryshe te arka. | **Në proces!**<br><br>Inspektorët kanë shtuar kujdesin që pagesat të jenë sipas çmimeve në raftet e marketeve. | **https://2lonline.com/ndeshkohen-marketet-per-mos-perputhje-te-cmimeve-ne-raft-e-arke** | Numri i vogël i inspektoreve komunal | |
| 7.1 | | Mungesa e kapaciteteve profesionale të inspektorëve | Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektoret | Drejtoria e Inspekcionit,<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore | TM1 dhe TM2 2025 | IKAP Harton dhe zbaton planin vjetor të trajnimeve për nëpunësit civilë, identifikon nevojat kapacitare dhe përmirëson cilësinë e materialeve shkolluese<br><br>Ofrohen grupe trajnimi që përfshijnë tema strategjike si planifikim urbanistik, financa publike, menaxhim projektesh dhe SIG (Sistemet e Informacionit Gjeografik); | **Në proces!**<br><br>Mungon bashkëpunimi i drejtpërdrejtë mes komunave, IKAP, për planifikim të | **https://ikap.rks-gov.net/trainings**<br><br>**smt-ikap.rks-gov.nete-prokurimi.rks-gov.netgzk.rks-gov.net** | Vazhdimësi dhe zgjerim **me** tema si planifikim dhe ndërtimi i qëndrueshëm. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | qëndrueshëm të kalendarit të trajnimeve. | | | |
| 7.2 | | Numër i pamjaftueshëm i inspektorëve | Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja | Kryetari i komunës<br><br>Drejtoria e Inspekcionit | TM1 dhe TM2 2025 | Misioni i Drejtorisë së Inspeksionit përmes inspektorve të saj: bën zbatimin e ligjit sa i përket mbikëqyrjes dhe inspektimeve në sferën ndërtimit, tregëtisë, komunikacionit, shërbime publike dhe ambijentit si dhe të gjithave inspektimeve tjera të cilat janë kopetencë dhe përgjithësi e kësaj drejtorie në pajtim me legjislacionin në fuqi. | **E realizuar!** | Plani i Punës 2025 - Drejtoria Inspeksion | Ndryshimet e shpeshta në legjislacion | |
| 8. | ARSIMI PUBLIK | Planifikimi i i shërbimeve arsimore jo adekuat dhe i paefektshëm | Të sigurohet planifikimi i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes apo zvogëlimit të numrit të nxënësve. | Drejtoria e Arsimit | TM1 dhe TM2 2025 | Drejtori i Arsimit i Komunës së Gjilanit mori pjesë në prezantimin e raportit “Indeksi i Sigurisë në Shkolla – Faza e Parë”, të publikuar nga Instituti për Drejtësi, Edukim dhe Avancim.<br>Ky raport bazohet në hulumtime të periudhës 2022–2024 dhe përfshin të dhëna nga MAShTI, Policia e Kosovës dhe institucione të tjera, duke ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e sigurisë në shkolla.<br><br>Drejtori i Arsimit ne Gjilan theksoi se kampuset shkollore në Gjilan ofrojnë kushte infrastrukturore që mundësojnë siguri të avancuar për nxënësit.<br>Ai mirëpriti rekomandimet për përmirësimin e rregulloreve komunale, bashkëpunimit institucional dhe forcimin e mekanizmave të raportimit, duke ritheksuar përkushtimin e DKA-së për një mjedis të sigurtë, të shëndetshëm dhe gjithëpërfshirës për nxënësit dhe stafin arsimor. | **E realizuar!**<br><br>DKA reflekton përkushtim të vazhdueshëm për përmirësimin e sigurisë në shkolla. | https://gjilan.rks-gov.net/news/nuhiu-shkollat-ne-gjilan-ofrojne-kushte-infrastrukturore-qe-mundesojne-siguri-te-avancuar-per-nxenesit/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/vendoset-gurthemeli-i-shkolles-se-mesme-te-mjekesise-ne-gjilan/ | Siguria në shkolla vazhdon të jetë një sfidë e madhe, | |
| 8.1 | | | Planifikimi i mirëfilltë i konkurseve duke u | Drejtoria e Arsimit | TM1 dhe TM2 2025 | Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit në Platformën eKosova është lansuar shërbimi ” “Apliko për paraqitje të provimit të maturës” | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/news/ne-bashkepunim-me-ministrine-e- | Një analizë të brendshme | Viteve në vijim planifikimi të bëhet më |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | bazuar në analizë të brendshme | | | Nga viti 2025 të gjithë maturantët që kalojnë me sukses provimin e maturës shtetërore do të kenë mundësinë ta shkarkojnë certifikatën e tyre në formë elektronike përmes platformës eKosova.<br><br>Konkurset :<br>- https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Konkurs-per-sekretar-shkolle.pdf<br>- https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Konkurs-per-plotesimin-e-vendeve-te-lira-te-punes-pedagog.pdf<br>- https://gjilan.rks-gov.net/konkurset-njoftimet/<br>- https://gjilan.rks-gov.net/news/perurohet-kendi-i-ri-gjitheperfshires-i-lojerave-ne-cerdhen-publike-dardania/ | Komisionet e Pranimit në bazë të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil. | arsimit-ne-platformen-ekosova-eshte-lansuar-sherbimi-apliko-per-paraqitje-te-provimit-te-matures/ | sa më të saktë. | herët para përfundimit të gjysmë vjetorit të dytë. |
| 8.2 | | | Fillimi i procedurave të prokurimit me kohë për shërbimet e nevojshme në fushën e arsimit | Drejtoria e Arsimit | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit ka ndërmarrë të gjitha përgatitjet e nevojshme për fillimin e suksesshëm të vitit shkollor 2025/2026.<br><br>Në kuadër të këtyre përgatitjeve, janë shpallur dhe proceduar tenderët për furnizimin e shkollave me materialet dhe resurset bazë, përfshirë: furnizimin me ditarë për nxënës, furnizimin me lëndë djegëse (dru dhe pelet), si dhe artikuj të tjerë të nevojshëm për funksionimin normal të institucioneve arsimore.<br><br>Për më shumë detaje mbi tenderët dhe specifikat e kontratave, mund të referoheni në linkun përkatës të publikuar nga autoriteti kontraktues. | **E realizuar!**<br><br>Të gjitha procedurat e parapara janë realizuar sipas planit dhe në kohë, duke siguruar gatishmëri të plotë për fillimin e vitit të ri shkollor. | https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/njoftim-per-kontrate/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/B05-Njoftim-per-Kontrat-Furnizim-i-shkollave-me-ditar-per-nxenes.pdf | Vështirësi janë hasur kryesisht në koordinimin e afateve të prokurimit me nevojat emergjente të shkollave. | Inicimi me kohë dhe monitorimi i kontratave. |
| 8.3 | | Inspektimet e pa mjaftueshme të procesit mësimor | Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të | Drejtoria e Arsimit<br><br>Drejtoria për | TM1 dhe TM2 2025 | Plani Zhvillimor i Arsimit i Komunës së Gjilanit - 2023-2026 \| Vizioni: Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës që zhvillon potencialin dhe kompetencat e individëve, si dhe inkurajon mësimin gjatë gjithë jetës, në përputhje me trendët e transformimit global dhe zhvillimin | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/raportet-planet-3/ | Terreni i madh karshi numrit të vogël të ekipeve. | Të rritet numri i kontrolleve periodike. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | tij. Hartimi i raporteve të inspektimeve. | Shëndetësi | | ekonomik, kulturor e shoqëror në Komunën e Gjilanit e më gjerë.<br><br>Misioni: Ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor pa dallim, i cili ka për qëllim sigurimin e mirëqenies dhe konkurrencën në tregun e punës.<br><br>Të dhënat dhe aktivitetet specifike mund të gjenden në Raportin Vjetor të Drejtorisë së Arsimit, ku janë përmbledhur realizimet, sfidat dhe arritjet gjatë vitit 2024. | | https://gjilan.rks-gov.net/news/diskutohet-gjuha-e-shenjave-per-te-gjithe-dhe-prezantohen-gjetjet/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/shkolla-teknike-mehmet-isai-model-i-suksesit-ne-arsimin-profesional/ | | |
| 8.4 | | | Vlerësimi sistematik i performancës së punës së drejtorëve të shkollave | Drejtoria e Arsimit | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, përmes Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), ka zhvilluar dhe implementuar një instrument standard për matjen e performancës, duke e dorëzuar te të gjithë drejtorët e shkollave për vlerësime të rregullta dhe të individualizuara të punës së tyre.<br><br>Në vitin 2025, është organizuar për herë të parë nga Komuna trajnimi profesional “Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve me bazë në shkollë”, për 1,392 mësimdhënës, duke forcuar kapacitetet e drejtorëve për të menaxhuar procesin në përputhje me standardet lokale | **E realizuar!**<br><br>Procesi i vlerësimit është funksional dhe po zbatohet në mënyrë të rregullt nga DKA në bashkëpunim me drejtorët e shkollave. | https://2lonline.com/dka-per-here-te-pare-komuna-e-gjilanit-ofron-trajnim-profesional-per-1392-mesimdhenes/ | Ndikon në zbatimin e qëndrueshëm dhe cilësor të vlerësimit. | Të krijohen mekanizma të qëndrueshëm për monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës. |
| 9. | SHËNDETI PUBLIK | Hapësira dhe Infrastruktura shëndetësore jo e mjaftueshme dhe jo efikase në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. | Të bëhet analizë e detajuar më qëllim të përcaktimit të prioriteteve për përmirësime në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria për Shëndetësi | TM1 dhe TM2 2025 | Fusha e shëndetësisë, vazhdon të mbetet fokus i investimeve nga Komuna e Gjilanit. Kjo sferë çdo ditë e më tepër po zhvillohet, me qëllim që qytetarët të marrin shërbimet e duhura.<br><br>Janë bërë investime të mëdha e të cilat kanë krijuar kushte dhe shërbime më të mira për kujdesin e qytetarëve.<br><br>Mbi 2 milionë euro investime që përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë: QMF e re në Lagjen Arbëria, Mamografi – falas, Pap-test – falas, laboratorë për analiza | **E realizuar!**<br><br>Shërbimi i Kujdesit Shtëpiak (Paliativ), i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, ofron shërbime nëpër shtëpi<br><br>https://gjilan.rks- | https://gjilan.rks-gov.net/news/hyseni-mbi-2-milione-euro-investime-ne-shendetesi-qe-permiresojne-jeten-e-qytetareve/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/lagjja-arberia-eshte-me-qender-te-re- | Shëndetësia primare po përmirësohet përmes teknologjisë, qasjes më të lehtë te shërbimet dhe rritjes së efikasitetit në kujdesin ndaj pacientit. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | shëndetësore<br>. | | | gjaku në 5 fshatra, kujdes paliativ – nga 2 në 5 ditë në javë”,<br><br>Shërbimi i kujdesit shëndetësor në Gjilanit mbulohet nga 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), 12 Qendra te Mjekësisë Familjare (QMF) dhe 9 Ambulanta në Mjekësinë Familjare (AMF), 61 ordinanca private si dhe një numër i konsiderueshëm i laboratorëve dhe farmacive.<br><br>Ekzistojne edhe insttucionet tjera shendetesore si : Qendra për Shëndetin Mendor, Shtëpia për Integrim në Bashkësi, Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijës, Qendra per Punë Sociale dhe Qendrën e Kujdesit Ditor për Personat e Moshuar (ne realizim) | **gov.net/news/hyseni-eshte-rritur-numri-i-mjekeve-dhe-infermiereve-per-te-garantuar-sherbim-me-cilesor-dhe-me-te-afert-me-qytetaret/** | **te-mjekesise-familjare/** | | |
| 9.1 | | Mangësi në rregullat ivën e brendshme lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësor e dhe zbatimi jo i plotë i saj. | Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullativës. | Drejtoria për Shëndetë si<br><br>Drejtuesi t e Institucio neve Shëndetë sore | TM1 dhe TM2 2025 | Është caktuar zyrtari për arkiv dhe protokol në sektorin e administratës pranë Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Nagip Rexhepi" si zyrtar-sinjalizues, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve, duke filluar nga 01.07.2025.<br><br>Kemi mare edhe këto hapa : shtimi i kontrollit mbi vijueshmërinë e punës, menaxhimin e pasurisë brenda institucioneve shëndetësore, hapja e rregullt e kutive të ankesave dhe shqyrtimi i çdo ankese nga komisioni i emëruar dhe ndërmarrja e veprimeve të menjëhershme. | **E realizuar!**<br><br>Caktimin e zyrtarit sinjalizues është miratuar dhe është në fuqi | Vendim<br>Vendim Sinjalizuesi.pdf | Kemi plotësuar kërkesat ligjore. | Të vazhdohet përforcimi i strukturave. |
| 9.2 | | | Të funksionaliz ohet Sistemi i Informacioni t Shëndetësor | Drejtoria për Shëndetë si dhe Drejtuesi t e Institucio neve Shëndetë sore | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna mbështetet përmes platformës të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit për të lehtësuar procedurat për qytetarët (përzgjedhje apo ndryshim të mjekut familjar).<br><br>Të ardhurat nga paguesit e këtij shërbimi administrativ shkojnë drejt komunës, duke kontribuar në financimin lokal dhe burime operacionale. | **E realizuar!**<br><br>Ne do ta publikojmë raportin për vitin 2025 – ne raportimin korrik-dhjetor 2025<br>DSHMS 2024 - Raporti Permbledh | **Sistemi elektronik**<br><br>**https://ekosova.rks-gov.net/Service/14**<br><br>**https://gjilan.rks-gov.net/drejtoria-e-shendetesise-dhe-mireqenie-sociale/** | Mos funksionim i i plotë i sistemit ndikon në plotësimin e të dhënave për pacientet. | Të merren veprime të nevojshme nga MSH për funksionali zimin e sistemit. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Ky model paraqet një shembull funksional të bashkëpunimit mes institucioneve qendrore dhe lokale për ofrimin e shërbimeve digitale. | | | | |
| 9.3 | | Funksionimi i jo efikas i Sistemit të informacionit shëndetësor. | Të zhvillohet aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria për Shëndetë si dhe Licencimi i tyre | TM1 dhe TM2 2025 | Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Nagip Rexhepi" (miratuar në Kuvendin Komunal është dokument themelor që përcakton kornizën ligjore dhe funksionale për operimin institucional.<br><br>Statuti kontribuon gjithashtu në transparencë dhe llogaridhënie, duke vendosur standarde operacionale për menaxhim cilësor dhe funksional të shërbimeve të kujdesit shëndetësor primar në komunën tonë. | **E realizuar!**<br><br>Statutin është bazë për planet vjetore operative, strategjitë zhvillimore dhe bashkëpunimet ndërinstitucionale për projekte | [https://gjilan.rks-gov.net/statusi-qkmf/](https://gjilan.rks-gov.net/statusi-qkmf/)<br><br>Statuti-i-QKMF-Dr.Nagip-Rexhepi-finale. | Referoju web faqes dhe dokumeneteve ne kolonën Mjetet e verifikimit | |
| 10. | SHËRBIMET PUBLIKE DHE LICENCIMI I TYRE | Efikasiteti, efektiviteti, cilësia dhe transparenca jo e kënaqshme në ofrimin e shërbimeve publike | Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike . | Drejtoria për Administratë dhe<br><br>Njësia e TIK-ut | TM1 dhe TM2 2025 | Agjencia e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme në Platformën eKosova ka lansuar dy shërbime:<br><br>1.Divizioni për të huaj – Caktimi i terminit për aplikim për leje qëndrim për herë të parë [https://ekosova.rks-gov.net/Public/295](https://ekosova.rks-gov.net/Public/295)<br><br>2.Divizioni për të huaj – Caktimi i terminit për aplikim për vazhdim të leje qëndrimit [https://ekosova.rks-gov.net/Public/296](https://ekosova.rks-gov.net/Public/296) | **E realizuar!**<br><br>Të dy shërbimet janë funksionalizuar me sukses në platformën eKosova dhe janë të gatshme për përdorim nga qytetarët. | [https://gjilan.rks-gov.net/news/agjencia-e-shoqerise-se-informacionit-ne-bashkepunim-me-ministrine-e-puneve-te-brendshme-ne-platformen-ekosova-ka-lansuar-dy-sherbime/](https://gjilan.rks-gov.net/news/agjencia-e-shoqerise-se-informacionit-ne-bashkepunim-me-ministrine-e-puneve-te-brendshme-ne-platformen-ekosova-ka-lansuar-dy-sherbime/) | Adaptimi me procesin online të aplikimit. | |
| 10.1 | | | Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim, vendimi të merret nga zyrtari | Drejtoria për Shërbime Publike<br><br>Mbikëqyrësi i shërbimeve publike | TM1 dhe TM2 2025 | Për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë mes palëve të interesuara dhe zyrtarëve vendimmarrës, Komuna e Gjilanit ka ndarë qartë funksionet mes zyrtarëve profesionalë dhe atyre që merren me pagesa dhe dorëzim të vendimeve.<br><br>Vendimet merren nga zyrtarë profesionalë, ndërsa dorëzimi dhe shërbimi bëhet përmes zyrtarëve në Qendrën për Shërbime me Qytetarë. | **E realizuar!**<br><br>Përdorim efikas të sistemit të brendshëm dhe njoftimit elektronik. | [https://gjilan.rks-gov.net/drejtoria-per-administrate-e-pergjithshme/](https://gjilan.rks-gov.net/drejtoria-per-administrate-e-pergjithshme/)<br><br>[https://gjilan.rks-gov.net/qendra-per-sherbim-me-qytetare/](https://gjilan.rks-gov.net/qendra-per-sherbim-me-qytetare/) | Mund të krijojnë vonesa në trajtimin e kërkesave. | Të rriten kapacitetet teknike dhe humane |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër | | | Sistemi i Intranetit është funksional dhe lehtëson qarkullimin e dokumenteve brenda administratës, ndërsa palët njoftohen me kohë përmes SMS-ve për statusin e kërkesave të tyre. | | https://gjilan.rks-gov.net/njoftime-dhe-informata/ | | |
| 10.2 | | | Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbim të përvojave, punëtorive | Drejtoria për Shërbime Publike dhe<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore | TM1 dhe TM2 2025 | Profesionalizmi i stafit do të rritet përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe punëtorive, ndërsa trajnime të rregullta organizohen nga Qeveria e Kosovës dhe organizatat lokale e ndërkombëtare. | **E realizuar!** | https://gjilan.rks-gov.net/news/hyseni-npl-tregu-tregim-suksesi-kur-e-morem-mandatin-kishte-12-punetore-dhe-sot-ka-mbi-300/<br><br>https://gjilan.rks-gov.net/news/kryetari-hyseni-shetitorja-mbi-lumin-mirusha-eshte-ne-fazen-finale/ | | |
| 10.3 | | Mangësi në rregullativën e brendshme lidhur me licencimin e shërbimeve | Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit dhe parandalojnë vendimet subjektive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria përkatëse për Licencimin e Shërbimeve | TM1 dhe TM2 2025 | Bazuar në Udhëzim Administrativ ka për qëllim përcaktimin e procedurës për licencimin e arkitektëve dhe inxhinierëve të regjistruar në fushën e ndërtimit sipas Regjistrit të publikuar nga Ministria dhe nënshkrimin e licencave.<br><br>Më 25 janar 2025 në Sallën 1 Tetori në Prishtinë ishte një moment kyç ku morën pjesë 767 anëtarë themelues, duke reflektuar përkushtimin e komunitetit profesional për themelimin e një strukture funksionale dhe të pavarur. Gjatë këtij Kuvendi u mbajtën fjalime hapëse, përfshirë edhe atë të Ministrit Libur Aliu, dhe u realizua shpërndarja e licencave, që përfaqëson një hap të rëndësishëm në formalizimin e statusit profesional të arkitektëve. | **E realizuar!**<br><br>https://klankosova.tv/arkitektet-e-kosoves-sot-behen-me-ode/<br><br>https://www.facebook.com/kosova.architects/posts/935416655405708?ref=embed_post | REGJISTRI I INXHINIERËVE NË FU<br><br>REGJISTRI I INXHINIERËVE NË FU<br><br>REGJISTRI I INXHINIERËVE NË FU | Mungesa e një sistemi më të përpunuar elektronik për menaxhimin e dokumentacionit gjatë këtij procesi gjithashtu ka kufizuar efikasitetin dhe shpejtësinë e zbatimit. | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10.4 | | Kualifikimi i pamjaftues hëm i personelit për licencimin e shërbimeve | Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve | Drejtoria përkatëse për Licencimine Shërbimeve dhe<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore | TM1 dhe TM2 2025 | Më 25 janar 2025, përfaqësues nga Komuna e Gjilanit morën pjesë në Kuvendin themelues të Odës së Arkitektëve, ku u shpërndanë licencat dhe u zgjodh Bordi Drejtues me kryetar Uran Kyqyku. Ngjarja u mbajt në Sallën "1 Tetori" me pjesëmarrjen e 767 anëtarëve themelues dhe përkrahje nga ministri Liburn Aliu.<br><br>E gjitha bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 07/2023, për procedurën e licencimit të arkitektëve, inxhinierëve, elektro, mekanikës dhe komunikacionit. | **E realizuar!**<br><br>Aktivitete të planifikuara në Kuvend u realizua me sukses të plotë. | https://klankosova.tv/arkitektet-e-kosoves-sot-behen-me-ode/<br><br>https://mmphi.rks-gov.net/LicensingProgram/LicensingProgram?type=1067 | Nuk janë hasur vështirësi të theksuara gjatë organizimit dhe pjesëmarrjes në Kuvend. | |
| 11. | KOMUNIKIMI ME PALË TË JASHTME TË INTERESIT | Mungesa e transparencës dhe konsultimeve me palë të jashtme të interesit gjatë hartimit të rregulloreve dhe buxheteve komunale | Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb faqe, inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj.) | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria përkatëse dhe<br><br>Njësia e Informimit | TM1 dhe TM2 2025 | Komuna e Gjilanit, tashmë ka edhe ueb faqen e re të saj, me dizajn të ri dhe e cila ka qasje më të lehtë dhe mund ta ndiqni në vegzën https://gjilan.rks-gov.net/<br><br>Ueb faqja është funksionale, ku dhe ofrohen për qytetarët të gjitha informatat e të rëndësishme në kuadër të Komunës së Gjilanit: si lajme, njoftime, vendime dhe dokumente të rëndësishme<br><br>Me kalimin në ueb faqen e re, https://gjilan.rks-gov.net/ janë bartur të gjitha të dhënat nga ajo e vjetra e cila tashmë është e pa qasshme apo jashtë përdorimit.<br><br>Ueb-faqja komunale, https://gjilan.rks-gov.net/ është një faqe e rregulluar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është e njëjtë me ueb faqet e të gjitha komunave tjera të Kosovës. | **E realizuar!**<br><br>Faqja është zhvilluar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe ndjek modelin nacional.<br><br>Po ashtu web faqja e re është funksionale dhe aktive me dizajn të përmirësuar dhe qasje më të lehtë. | https://gjilan.rks-gov.net/news/funksionalizohet-ueb-faqja-e-re-e-komunes-se-gjilanit/ | .<br>Disa qytetarë kanë vështirësi të përshtaten me ndryshimine faqes së re. | |
| 11.1 | | Mungesa e partneritetit me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit dhe | Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria përkatëse dhe | TM1 dhe TM2 2025 | Për periudhën raportuese Janar-Qershor 2025 për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konfrom Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve Komuna e Gjilanit ka ndare gjithsej 360 000 €. | **E realizuar!**<br><br>Sipas ligjeve në fuqi, drejtori i buxhetit ka raportuar për shpenzimet | https://gjilan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Lista-paraprake-e-OJQ-ve-perfituese-sipas-Thirrjes- | Akterët institucionalë dhe OJQ-të nuk e kanë të kufizuar efektivitetin e | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bashkëpunimit me komuniteti të bizneseve | periodike konsultative | Njësia e Informimit | | Lista-paraprake-e-OJQ-ve-perfituese-sip<br><br>Lista-perfundimtare-e-projekt-propozim | buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar. | [Publike-te-DShMS-se-1.pdf/](Publike-te-DShMS-se-1.pdf/) | monitorimit të zbatimit të buxhetit. | |
| 11.3 | | | Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtoria përkatëse dhe<br><br>Njësia e Informimit | TM1 dhe TM2 2025 | Janë krijuar mekanizma të posaçëm si grupet teknike të punës, të cilat fokusohen në menaxhimin e riskut në fushat më të ndjeshme dhe më të ekspozuara ndaj korrupsionit. Këto grupe përbëjnë një platformë të hapur për përfshirjen aktive të organizatave joqeveritare (OJQ-ve), të cilat luajnë një rol kyç në parandalimin dhe identifikimin e rasteve me potencial të lartë korrupsioni.<br><br>Ky qasje reflekton përkushtimin e Komunës për transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në qeverisje, duke e vendosur bashkëpunimin me shoqërinë civile si një nga shtyllat kyçe të luftës kundër korrupsionit. Ndër organizatat që kontribuojnë aktivisht me programe dhe iniciativa konkrete janë:<br>• Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile ǀ Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF),<br>• Platforma CiviKos – Prishtinë<br>Ky bashkëpunim i strukturuar përbën një model të mirë të praktikës institucionale në nivel lokal, duke e vendosur Komunën e Gjilanit në mesin e institucioneve që mbështesin me vepra konkretizimin e luftës kundër korrupsionit përmes përfshirjes së shoqërisë civile. | **Ne proces!**<br><br>Ka përfshirje, por kërkohet strukturim më i mirë i kontributit të tyre. | [https://gjilan.rks-gov.net/news/nuhiu-komuna-e-gjilanit-bashke-me-handikosin-realizon-e-para-kete-projekt-te-rendesishem/](https://gjilan.rks-gov.net/news/nuhiu-komuna-e-gjilanit-bashke-me-handikosin-realizon-e-para-kete-projekt-te-rendesishem/)<br><br>[https://kcsfoundation.org/qendra-e-kcsf-se/](https://kcsfoundation.org/qendra-e-kcsf-se/)<br><br>[https://civikos.net/lista-e-anetareve/](https://civikos.net/lista-e-anetareve/)<br><br>dhe<br><br>[https://www.institutigap.org/spendings/?gjilan/2018#/~/klasifikimi-institucional/komunat/gjilan](https://www.institutigap.org/spendings/?gjilan/2018#/~/klasifikimi-institucional/komunat/gjilan) | Mungesa e mekanizmave të qartë për përfaqësim të barabartë. | |